



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 02.10.2019. ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, i ndryshuar”.

Marrin pjese:

Ermonela Felaj, Sadi Vorpsi, Eljo Hysko, Luan Duzha, Antoneta Dhima, Xhemal Qefalia, Alban Zeneli, Lefter Maliqi, Luan Harusha, Arben Elezi, Myslim Murrizi, Anduel Xhindi, Elena Xhina, Paulin Sterkaj dhe Adnor Shameti.

Mungojnë:

Edmond Rrushi dhe Ylli Shehu.

HAPET MBLEDHJA

Ermonela Felaj – Mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit parlamentar të Sigurisë Kombëtare.

Më lejoni t'i uroj mirëseardhjen një kolegeje të re, anëtare e përhershme e këtij komisioni, zonjës Artemis Dralo.

Urime për pjesëmarrjen tuaj!

Dua të them se është një gjë e mirë për këtë komision, sepse gjatë kësaj kohe kemi shënuar disa ndryshime, duke e çuar në pesë numrin e anëtareve të përhershme femra për sa u takon objektivave gjinore. Realisht është ecur mirë.

Sot kemi njoftuar për shqyrtimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, i ndryshuar”. Për hir të së vërtetës, kemi njoftuar para dy ditësh Ministrinë e Drejtësisë, por duke pasur parasysh se java që kaloi ishte java e gjelbër dhe ishim të ngarkuar me të gjitha problemet e asaj jave, kemi marrë një *e-mail* nga ana e ministres së Drejtësisë, ku na kërkohet ndjesë për pamundësinë e paraqitjes sot në komision, për faktin se nuk ka pasur mundësi ta kombinojnë me axhendat, por edhe për arsyen se në Shqipëri kanë ardhur disa deputetë gjermanë për çështjen e negociatave dhe ministrja kishte takim me ta. Ne e kemi pranuar ndjesën, kështu që do të organizojmë një mbledhje tjetër, ku ministria do të jetë personalisht për të prezantuar ndryshimet e sjella në ligjin “Për ekzekutimin e vendimeve penale”. Besoj se nuk keni vërejtje për këtë gjë.

Ndërkohë, dua t'ju bëj me dije se në mbledhjen e fundit disa deputetë të këtij komisioni, që i përkasin opozitës: zoti Murrizi, zoti Maliqi, zoti Çarçani, zoti Musaj, zoti Rrushi dhe zoti Shehu kanë bërë një kërkesë në Komisionin e Sigurisë Kombëtare, bazuar në nenin 36 të Rregullores së Kuvendit, ku kërkohet të thirret në komision drejtori i Drejtorisë për Sigurimin e Informacionit të Klasifikuar, zoti Dorian Tola, për të marrë informacion në lidhje me certifikatën e sigurisë së zotit Valdrin Pjetri. Kërkesa është korrekte në kuptimin formal dhe nga ana e kriterëve që imponon neni 36 i Rregullores, sepse është nënshkruar nga më shumë se 6 deputetë, për të cilët unë kam vënë verifikim me stafin e komisionit dhe janë të pajisur me certifikatë sigurie, ndaj në momentin më të parë ne do ta bëjmë këtë mbledhje.

Po ashtu, dua t'ju bëj me dije se jemi munduar të ndërtojmë një kalendar, duke pasur parasysh që para diskutimit të buxhetit të përfundojmë të gjitha vizitat që kemi nisur në drejtoritë e policisë dhe të ecim edhe me pjesën e ligjeve.

Këtë të premte kemi njoftuar për një vizitë në Drejtorinë për Bashkëpunëtorët e Drejtësisë, vizitë e rakorduar edhe me përfaqësuesit e Ministrisë së Brendshme, prandaj ftoj kolegët, që kanë mundësi, të na bashkohet ditën e premte në këtë vizitë.

Gjithashtu, ka ardhur një ftesë nga ana e Autoritetit të Dosjeve për Komisionin e Sigurisë, për nesër në orën 10:30. Do të zhvillohet një ceremoni në mjediset e Ministrisë së Mbrojtjes. Autoriteti i Dosjeve do të marrë një nga godinat e Ministrisë së Mbrojtjes për të ushtruar aktivitetin e vet.

Pasnesër kemi vizitë te Mbrojtja e Dëshmitarëve. Për të gjithë ju, vendi është aty ku ishte edhe FNSH-ja. Domethënë, duhet të dilni në autostradë dhe atje është. Nesër ka seancë, por gjatë kohës, kush të ketë dëshirë, mund të organizohet në grup dhe të shkojmë tek Autoriteti i Dosjeve. Do të flasim edhe nesër gjatë paradites për organizimin. Autoriteti për Informimin për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit ka kënaqësinë t'ju ftojë në ceremoninë e shpalljes së projektit të rikonstruksionit të ndërtesës së AIDS-së dhe shërbimeve etik, për krijimin e një arkiv moderne në kuadër të bashkëpunimit mes AIDS-së dhe agjencisë suedeze për zhvillim ndërkombëtar në Tiranë, ora 10:30. Kjo është ftesa.

Nëse ka ndonjë sugjerim, gjatë javës tjetër, nga e hëna deri të mërkurën kryesia e komisionit nuk do të jetë, sepse jemi të ftuar në një aktivitet që zhvillohet në Londër, prandaj ngelet e enjtja, kur ka parlament. Ditën e premte kemi planifikuar të bëjmë një vizitë në Drejtorinë e Policisë së qarkut Shkodër. Kjo është një vizitë e rakorduar të premten që vjen. Na ngelen edhe dy vizita për të bërë, njëra në Lezhë, të cilën nuk e bëmë, sepse sapo është ndërruar drejtori dhe na u kërkua pak kohë, dhe tjetra në Korçë, të dyja do t'i planifikojmë në vijim.

A ka ndonjë sugjerim tjetër? Këto ishin gjërat, të cilat ne i kemi diskutuar edhe më parë dhe i kemi vendosur në kalendar.

Për sa u takon akteve ligjore, kemi ligjin “Për ekzekutimin e vendimeve penale”. Para datës 18 duhet të mbyllim një projekt të sjellë nga Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme për masat shtrënguese ndërkombëtare dhe jemi komision përgjegjës. Kjo është agenda që kemi për tetorin.

Në vijim duhet të përzgjedhim bashkë disa bashki, ku do të shkojmë. Do të ishte mirë, për shkak të temës, të zgjidhnim bashkitë që janë më të rrezikuara. Ne kemi miratuar ligjin “Për emergjencat civile”, por shumë nga bashkitë nuk janë të mirinformuara për detyrimin që kanë, sipas këtij ligji, që 4% të buxhetit të tyre duhet ta dedikojnë për emergjencat civile, i cili, nëse nuk përdoret në vitin pasardhës, merret nga ministria përkatëse. Prandaj, edhe për t'i informuar për pjesën e ligjit, por edhe për të rritur veprimin në këtë drejtim të disa bashkive,

duhet të organizojmë takime me këtë temë. Pra, bashkë do të zgjedhim 3-4 bashki ku mund të shkojmë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, duhet planifikuar konkretisht, sepse është e kushtëzuar. Prefekti nuk e miraton buxhetin nëse 3% e tij nuk planifikohet për emergjencat, sepse në të kundërt digjet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, duhet planifikuar për çfarë do të përdoret, nëse do të ndërtohet një urë, do të blihet një borëpastruese apo zjarrfikëse. Unë shikoj se ka nevojë që ne ta shpjegojmë edhe për faktin që ligji u miratua në fund, por nuk janë të informuar për detyrimin që kanë, pra mirë do të ishte që ne si komision të vihem në krye të kësaj iniciative.

A ka ndonjë gjë tjetër?

Myslim Murrizi – Zonja kryetare, dua t'ju pyes për vetingun në polici. Ju keni bërë një seancë me kryetaren e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit Kalimtar, ku unë nuk kam qenë prezent për arsye objektive, çfarë raportoi për vlerësimin kalimtar të 300 gradave madhore në polici? Dje pashë një lajm, ku 3 sekretarë nga ky komision dhe dy anëtarë kanë dhënë dorëheqjen dhe më duket se ka vende vakante, të cilat nuk janë plotësuar. A do të operohet me dosjet e para, sepse deri tani janë përzgjedhur 45 dosje, por nuk po shohim gjë? Nëse ecët me këtë ritëm, atëherë nuk do të bëhet kurrë.

Ermonela Felaj – Në fakt, ne e thirrëm për këtë shkak, por edhe për të qenë në rregull me detyrimet tona ndaj procesit. Procesverbali i mbledhjes është zbardhur dhe do t'ua vëmë në dispozicion të gjithë kolegëve të nënkomisionit.

Është e vërtetë që kryetarja e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit u shpreh se ka disa probleme, me lëvizjen e ndonjë anëtari të komisionit apo sekretariatit. Gjithashtu e di që po operojnë për të zëvendësuar postet me ata që janë në lista.

Nga një informacion që sapo mora, dua t'ju them se ditën e hënë, në datën 7, në orën 09:30 ky komision do të hedhë shortin e dytë për 45 dosjet e para. Ata u shprehën se janë duke punuar dhe ishin optimist, sepse pretendonin t'i mbaronin brenda këtij muaji. Prandaj për shortin e dytë, duhet të caktojmë një përfaqësues nga nënkomisioni që të jetë prezent, sepse ne të tre nuk do të jemi. Kush nga kolegët do të shkojë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord, mund të shkoni të dy në orën 09:30. Sadi ka qenë në hedhjen e shortit të parë që është bërë në datën 1 qershor....

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, ata janë të detyruar të na njoftojnë çdo herë.

Ndërkohë, një nga vizitat e planifikuara, por nuk e thashë, është që do të shkojmë në ambientet ku ushtrojnë detyrën komisionerët e vetingut, sepse nuk kemi qenë ndonjëherë. Kjo ishte dëshira e të gjithë anëtarëve e Këshillit të Vlerësimit, që të kishin një kontakt me ne, sepse kanë disa vështirësi. Kur të shkojmë atje do t'i shikojmë dhe dëgjojmë nga afër dhe mund të ndërtojmë një material për të lehtësuar punën e tyre, sepse ne ua vendosëm atyre afatin 1-vjeçar, nuk na detyroi dikush tjetër.

A ka diçka tjetër? Nuk ka.

Atëherë, ju falënderoj që ishit prezent dhe besoj se do të vazhdojmë sipas agjendës që thamë.

Ditë të mbarë!

Mbledhja mbyllet.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA